



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam

Department of Economy, Development and Tourism

Nr. i prot. 6140 Më 18.12.2025  
Pr. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

# Ri Shpallje për Shfrytëzimin e Shtandeve Mobile Të Drurit

## Qëllimi

Komuna e Rahovecit, rishpall thirrjen publike për dhënie në shfrytëzim të shtandeve mobile të drurit. Shtandet jepen në shfrytëzim për persona fizik dhe juridik. Bizneset do të ofrojnë produkte të gastronomisë dhe shërbime me tematikë dimërore dhe turistike.

## Vendi

- Thirrja do të jetë e hapur nga data 18.12 deri më -22.12.2025, nga ora 8:00 deri më 16:00.
- Hapja e ofertave do të behet me date 19.12.2025 me fillim nga ora 13:00 në sallën e kuvendit komunal.
- Shfrytëzimi nga data 20.12 deri më 15.01.2026.
- Përzgjedhja e përfituesve bëhet nga komisioni komunal.
- Numri i shtandeve është i kufizuar.
- Bizneset duhet të operojnë} do ditë nga ora 12:00 deri në ora 23:00

## Kriteret

- Përfituesit e shtandeve menjëherë pas përfitimit nga kjo thirrje janë të obliguar të bëjnë dekorimin e shtandit përfitues dhe hapësirës përreth.
- Bizneset duhet të jenë të regjistruara në ARBK dhe të veprojnë në Komunën e Rahovecit.
- Lejohen vetëm artikujt e miratuar në aplikim.
- Detyrim për vendosjen e shportave të mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë.
- Lokacionet e shtandave -sheshi qendror në Rahovec.

---

## Përparësitë në Përzgjedhje

Përparësi do të kenë bizneset që:

- Promovojnë produkte **vendore/lokale**.
- Ofron produkte ushqimore **inovative** ose me motive dimërore/festive.

---

## Kritere Objektive për Përzgjedhje

- Produkte vendore/tradicionale.
- Brendim i rregullt dhe imazh profesional.
- Produkte inovative me motive festive.
- Përvojë në aktivitete turistike ose panaire.
- Koncept festiv i qartë dhe i realizueshëm.

---

## Kodi i Mirësjelljes dhe Obligimet Shtesë

Bizneset janë të obliguara të tregojnë bashkëpunim të mirëfilltë.

**Rreptësisht ndalohe:**

- Kryerja e veprave të paligjshme ose akteve të dhunshme.
- Abuzimi verbal ose fizik ndaj personave.
- Shitja e produkteve që nuk janë të paraparë në aplikim.
- Mosmbajtja e pastërtisë brenda dhe jashtë shtandit.

---

## Mënyra e Aplikimit

Të plotësohet aplikacioni i bashkangjitur dhe të dorëzohen dokumentet:

**Dokumentet e domosdoshme**

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit (me veprimtari).
- Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit
- Vertetimi i taksave komunale.

- Vërtetimi i tatimit në prone për personat fizik

Aplikuesit që ofrojnë ushqim dhe/ose pije duhet të paraqesin menynë përkatëse.

### **Rregulla të aplikimit**

- Lejohet vetëm **një aplikim për një person juridik.**
- Aplikuesi duhet të jetë **pronar i biznesit.**

### **Afati i Aplikimit**

**18/12/2025 – 22/12/2025**

**Ora: 08:00 – 16:00**

**Vend: Drejtoria e Administratës së Përgjithshme**

Çdo aplikim duhet të protokollohet me emërtimin:

**“Kërkesë për marrjen në shfrytëzim të shtandeve mobile të drurit”**

Pas shqyrtimit, kandidatët do të njoftohen për nënshkrimin e kontratës.

---

## **Vërejtje**

Biznesi që fiton të drejtën e shfrytëzimit **nuk ka të drejtë të nënkontraktojë** ose të bëjë marrëveshje me ndonjë biznes tjetër për operim. Në të kundërt, kontrata ndërpritet.